



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH
POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

STRATEGJIA NACIONALLE PËR
SIGURI NË BASHKËSI DHE PLANI
I VEPRIMIT
2018 - 2023

SHKURTESAT

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme;

DSP – Departamenti për Siguri Publike – Ministria e Punëve të Brendshme;

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

PK – Policia e Kosovës;

IPK – Inspektorati Policor i Kosovës;

ZK/ZKM – Zyra për Komunitete/Zyra e Kryeministrit të Kosovës;

ZP – Zyra e Presidencës;

KKSB – Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi;

EVSB – Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi;

KLSP – Këshilli Lokal për Siguri Publike;

U.S Department of Justice – ICITAP – Ministria e Drejtësisë e SHBA-ve, Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnime për Hetime Penale;

LMT-KFOR- Liaison Monitoring Team – Ekipet Monitoruese Ndërlidhëse të KFOR-it;

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian;

OJQ- Organizatat Joqeveritare;

UNDP/FERM- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara – Programi FERM.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Fenomeni i sigurisë ngërthen në vete një mori sfidash për shoqërinë Kosovare në përgjithësi si dhe për mekanizmat e shtetit në veçanti. Problemet të cilat ndikojnë në sigurinë në bashkësi, që nga aktet kriminale në fushën e sigurisë në bashkësi e deri tek problemet e funksionimit të mekanizmave relevant në këtë fushë, janë një ndër sfidat kryesore për shtetin dhe shoqërinë tonë.

Strategjia për Siguri në Bashkësi është dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat parandaluese që duhen ndërmerren kundër fenomeneve negative. Ky dokument strategjik, rrjedh nga prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar dhe kontribuon në adresimin e prioriteteve të Qeverisë për të krijuar një ambient të sigurt në bashkësi për të gjithë, duke punuar me komunitetin në gjetjen e zgjidhjeve lokale me qëllim të rritjes së sigurisë dhe adresimit të sfidave tek institucionet përkatëse.

Objektivat e përcaktuara qartë janë të bazuara mbi masat publike dhe aktivitetet për t'u mbështetur në mënyrë institucionale dhe financiare, të cilat mund të verifikohen nëpërmjet një monitorimi të detajuar dhe procesit të vlerësimit.

Qasja strategjike e cila është ndërtuar për parandalimin e dukurive negative është bazuar në përvojën e deritanishme, përkatësisht në politikat e ndërmarra nga institucionet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës si dhe në vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, në mënyrë që të ndërtohet një vizion afatgjatë për masat parandaluese. Hartimi i kësaj strategjie është bazuar gjithashtu në politika të avancuara të Bashkimit Evropian, si dhe agjencitë të tjera ndërkombëtare të cilat trajtojnë këtë fushë.

Qëllimi i kësaj Strategjie dhe Plani i Veprimit është që të fuqizojë përpjekjet institucionale në nivelin qendror dhe lokal dhe aktorëve të tjerë në parandalimin e dukurive negative që cenojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve në përgjithësi, gjithmonë duke marr parasysh rekomandimet që dalin nga raportet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, raportet e Komisionit Evropian, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Strategjia ofron kornizë legislative dhe institucionale për parandalimin, duke definuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve në përputhje me objektivat e strategjisë. Ky dokument strategjik reflekton mbi gjendjen ekzistuese, trendët dhe politikat e ndërmarra në nivel qendror dhe lokal

duke ofruar masa konkrete të cilat janë të arritshme në aspektin buxhetor, resurseve njerëzore dhe siguron koherencë të zhvillimit dhe zbatimit të politikave strategjike në nivel vendi.

Në pjesën hyrëse të strategjisë janë paraqitur aspekte të ndërlidhjes së kësaj strategjie me prioritetet e Qeverisë dhe nevojën për hartimin e saj. Një pjesën metodologjike pasqyrohen ministritë dhe institucionet kryesore të përfshira në hartimin e dokumentit, si dhe rolin organizatave ndërkombëtare ose organizatave të shoqërisë civile në hartimin e tij. Kjo pjesë gjithashtu paraqet qasjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë këta akterë, dhe akterët të cilët janë konsultuar gjatë procesit të hartimit.

Vizioni i ndërtuar në kuadër të kësaj strategjie synon adresimin e problemeve të shumta me të cilat shoqëria jonë, por edhe e vendeve të tjera ballafaqohen me dukuri të krimeve të ndryshme.

Kjo strategji synon të përmirësojë mjedisin ligjor dhe institucional, të fuqizojë bashkëpunimin qytetar me institucione lokale, ndërkombëtar me qëllim të parandalimit të dukurive negative të cilat cenojnë sigurinë në bashkësi. Duke zbatuar këtë vizion, ne do të kemi një shoqëri ku Kosova do të jetë një vend me siguri të lartë njerëzor, me emancipim të lartë gjinor dhe shoqëri gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Siguri në Bashkësi mundëson qasje të integruar dhe pro-aktive me qëllim të parashikimit dhe përgatitjeve të përgjigjeve më të përshtatshme ndaj këtyre problemeve, duke njohur dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ofron mjedisi strategjik.

Strategjia është vazhdimësi e zbatimit të konceptit të sigurisë në bashkësi si formë dhe mënyrë bashkëkohore e zhvillimit të politikave në nivel lokal si dhe koordinimi në zbatimin e drejtpërdrejtë për interesin e qytetarëve. Andaj, kemi përcaktuar si prioritete objektivat strategjike, duke besuar se realizimi i tyre është i mundshëm me kosto të pranueshme financiare dhe me ndikim të menjëhershëm në përmirësimin e sigurisë në bashkësi.

Kjo strategji do të shërbejë si udhërrëfyes dhe plan punues për të gjitha ato institucione që kanë mandat apo përgjegjësi për sigurinë në bashkësisë.

Gjithashtu, kjo strategji ofron një kornizë institucionale që do të punojnë në partneritet në mes nivelin lokal dhe institucionet e sigurisë me qëllim të përmirësimit të sigurisë në bashkësi dhe zvogëlim të krimit.

Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në analizat dhe në vlerësimet e gjendjes aktuale dhe nevojat për adresimin e problemeve përkatëse në këtë fushë. Po ashtu, duke iu referuar konsensusit të të gjithë anëtarëve të GP, institucioneve pjesëmarrëse në procesin e hartimit të strategjisë.

Objektivat strategjike janë 5 (pesë):

- Fuqizimi i kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë që merren me parandalim të dukurive negative me qëllim të uljes së nivelit të krimit dhe problemeve të siguri në bashkësi;
- Gjithë përfshirja e komuniteteve në mekanizmat e sigurisë në bashkësi;
- Koordinimi ndërinstytucional në të gjitha nivelet dhe bashkëpunimi me qytetarë;
- Vetëdijesimi i qytetarëve për kërcënimet e sigurisë në bashkësi;
- Avancimi i bazës ligjore lidhur me mekanizmat e sigurisë në bashkësisë.

HYRJE

Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe progresi i shoqërisë. Shqyrtimi i mjedisit strategjik, nxjerr në pah se rreziqet ndaj sigurisë në bashkësi nuk janë të izoluara nga njëra-tjetra, por të lidhura dhe të ndërvarura. Siguria jonë ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që zbehin dhe dëmtojnë sigurinë në bashkësi.

Mënyrat dhe rrugët që zgjedhim sot për t'u përballur me problemet, do të përcaktojnë një siguri për të ardhmen e qytetarëve.

Kjo strategji është në përputhje me prioritetet kryesore të Qeverisë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, e që është siguria e brendshme dhe e jashtme, e përfituar nëpërmjet qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe profesionalizmit të institucioneve të specializuara, si dhe garantimit të kushtetutshmërisë dhe funksionimit të institucioneve demokratike për çdo vend sovran.

Strategjia, fokus kryesor do ta ketë adresimin e sfidës së zbatimit të kornizës ligjore për këtë fushë, të përmirësojë, ku është e nevojshme, në përputhje me standardet evropiane. Me theks të veçantë, strategjia synon rritje të aktivizimit dhe vullnetarizmit qytetar në fushën e sigurisë në bashkësi. Gjithashtu, duhet të punohet edhe më shumë në rritjen e pjesëmarrjes së grave në forumet dhe mekanizmat e tjerë të sigurisë. Fokus tjetër do ta ketë ofrimin e një kornize se si

institucionet e Republikës së Kosovës do të punojnë në partneritet me nivelin lokal, komunitetin dhe institucionet e sigurisë në përmirësimin e sigurisë dhe zvogëlimin e krimit. Aktivitetet do të shërbejnë si përgjigje ndaj problemeve të sigurisë në bashkësi, duke përfshirë edhe perceptimin e sigurisë dhe të dhënave të krimit, me fokus në grupet më në rrezik.

Gjithashtu, kjo strategji do të shërbejë edhe në realizimin e objektivave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në periudhën e ardhshme afatmesme, e që është: forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse për monitorim të progresit në vazhdimësi, edhe do të ndihmojë në adresimin e frikës dhe perceptimeve të qytetarëve të Kosovës.

Kjo strategji tenton të adresojë çështjet specifike, të përshkruara në planin e veprimit të SNSB, duke krijuar kështu edhe programe të veçanta për adresimin e tyre në nivelin komunal. Përcaktimi i nivele të krimit dhe të çështjeve me interes do të ndihmojë institucionet përkatëse në përcaktimin e prioriteteve, veçanërisht në nivelin komunal.

Prioritet e zgjedhura dhe të përcaktuara në planin e punës janë thelbësore, janë sfida me të cilat qytetari i Kosovës atakohet çdo ditë. Realizimi i tyre i bën përfitues të gjithë qytetarët pa dallim nga statusi socio-politik, socio-ekonomik, etnik, fetar, gjinor, apo të tjetër. Gjithashtu, siguria në përgjithësi reflekton në ruajtje e pronës publike dhe private, qasje më të lehtë në marrjen e shërbimeve nga institucione shëndetësore dhe në administratë, siguri personale në rrugë, shtëpi dhe në shkollë.

METODOLOGJI

Hartimit të Strategjisë për Siguri në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2018-2022, i ka paraprirë vlerësimi gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit ¹. Po ashtu, janë analizuar në detaje të gjitha raportet e mekanizmave relevante të pushtetit lokal dhe qendror, ndërkombëtar, shoqërisë civile, etj.

¹Raporti Vlerësues, Zbatimi i Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe i Planit të Veprimit gjatë vitit 2015, Prishtinë, Mars, 2016

Procesi i hartimit të strategjisë është koordinuar në mes të ekipit për hartimin e SNSB². Ekipi punues për hartimin e strategjisë, ka analizuar gjendjen aktuale, ka identifikuar sfidat që duhet adresuar me këtë strategji, si dhe ka përcaktuar objektivat dhe aktivitetet të cilat do të realizohen me planin e veprimit.

Ekipi punues ka mbajtur 4(katër) takime në të cilat është diskutuar për mënyrën dhe formën e hartimit të kësaj strategjie. Më 6 dhe 9 shtator 2016 ka realizuar punëtorinë 3 ditore ku është bërë finalizimi i dokumentit.³

Institucionet e përfshira në grupet e punës:

- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Policia e Kosovës;
- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Ministria e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Forumet e sigurisë (KKSB, EVSB, KLSP).

Organizatrat ndërkombëtare, OJQ-të, të cilat kanë ndihmuar në hartimin e këtij dokumenti:

- U.S- Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve/Programi ICITAP;
- OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian;
- UNDP/FERM-Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara – Programi FERM;
- QKSS- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë;
- KLLGI- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Save the Children.

²Vendimi i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me nr. 198/2016, dt. 11.07.2016

³Punëtorja për finalizimin e strategjisë është mbështetur nga Projekti FERM I UNDP-së.

Ministria e Punëve të Brendshme është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj të gjithë akterëve të cilët kanë kontribuar në hartimin e kësaj strategjie, duke ndihmuar institucionet në nivelin qendror dhe lokal për mënyrën dhe formën e konceptit të sigurisë në bashkësi, bërjen e qytetarit pro-aktiv si dhe krijimin e bazës ligjore të funksionimit të Forumeve të Sigurisë.

STRATEGJIA SI PËRGJEGJËSI E QEVERISË SË KOSOVËS

Strategjia është e koncentruar për të ofruar zgjidhje ndaj problemeve të sigurisë publike, personale dhe të pronës, kjo strategji ka karakter vendor, ku përgjegjës në realizimin objektivave strategjike dhe aktiviteteve e ka përsipër Qeveria e Kosovës, nëpërmjet institucioneve të saja.

PËRKRAHJE FINANCIARE

Ekziston shqetësimi real që në vitet në vijim donatorët ndërkombëtar do të shkurtojnë fondet për çështje të caktuara. Andaj është e domosdoshme që nëpërmjet kësaj strategjie të bëhet një planifikim financiar i tranzicionit. Deri më sot, financimi për projektet e sigurisë është realizuar kryesisht nga organizata ndërkombëtare. Rreziku potencial, në këtë rast, do të ishte nëse këto organizata bëjnë një tërheqje të menjëhershme dhe të paplanifikuar. Kjo do të rrezikonte në masë të madhe konceptin e sigurisë në bashkësi. Andaj, mbështetja financiare dhe planifikimi i buxhetit për të mbështetur realizimin e aktiviteteve nga Qeveria e Kosovës është i domosdoshëm. Efekti financiar i strategjisë do të mbulohet kryesisht nga buxheti i Kosovës, i lidhur dhe i harmonizuar me sektorët e tjerë të arsimit, policisë, MPB-së dhe komunave të Kosovës.

QËNDRUESHMËRIA

Strategjia është konceptuar si një platformë objektivash që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Qeveria si përgjegjëse kryesore, por edhe grupet e tjera, do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e strategjisë. Qeveria do të jetë e vëmendshme për të përshtatur çdo vit, mbi bazën e rezultateve të monitorimit, objektivat dhe aktivitetet me situatën reale të krijuara.

Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar realizimin e mbështetjes financiare me qëllim të zbatimit të kësaj strategjie.

Qeveria e Kosovës, gjatë hartimit të strategjisë, ka treguar kujdes që objektivat e vendosura të jenë të qarta, të përcaktuara mirë dhe të realizueshme, të mbështetura kryesisht në burimet materiale, financiare dhe njerëzore të cilat i ka sot Kosova.

DISA NGA FAKTORËT QË E FAVORIZOJNË JETËSIMIN E STRATEGJISË:

- Ekzistojnë akte nënligjore që përcaktojnë themelimin e disa prej forumeve të sigurisë në bashkësi që adresojnë çështjet e sigurisë në bashkësi;
- Themelimi dhe funksionimi i forumeve të sigurisë në shumicën e komunave të Kosovës, të cilat veprojnë që nga viti 2004.⁴
- Mekanizmat e themeluar sipas normave ligjore si dhe nga praktika e deritanishme krijojnë kushte të volitshme për të garantuar koordinimin efikas si dhe gjithë përfshirjen;
- Ekziston mbështetja serioze nga partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

DISA NGA FAKTORËT QË VËSHTIRËSOJNË DHE RREZIKOJNË JETËSIMIN E STRATEGJISË:

- Mungesa e përvojës institucionale, veçanërisht në kapacitetet zbatuese të administratës publike dhe strukturave të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave;
- Vetëdijesimi për rëndësinë e këtyre mekanizmave ende nuk është në nivelin e dëshiruar. Ky vetëdijesim, duhet të ekzistojë tek qytetarët e Kosovës, por gjithashtu edhe tek institucionet përkatëse, të cilat, ose janë aktorë kryesorë ose mbështetës të këtij procesi, si: MPB, MAPL, kryetarët e komunave, Ministria e Financave;
- Mungesa e mbështetjes financiare nga niveli qendror.

KORNIZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
- Ligji Nr. 03/L-035 për Policinë e Kosovës, 2008;
- Ligji Nr. 02/L-70 për Sigurinë dhe Komunikacionin Rrugor, 2007;
- Ligji Nr. 02/L-41, për Mbrojtje nga Zjarri, 2006;
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;

⁴Raporti vlerësues për zbatimin e strategjisë nacionale për siguri në bashkësi dhe plani i veprimit gjatë vitit 2015, Prishtinë, Mars 2016.

- Ligji Nr. 03/L- 145 për Fuqizimin dhe Pjesëmarrje të Rinisë (për vullnetarizëm);
- Ligji Nr. 05/L- 22 për Armët, 2015;
- Ligji për Përdorim Civil të Eksplozivëve;
- Strategjia për Armët e Vogla dhe të Lehta;
- Udhëzimi Administrativ Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi(KKSB).

NDËRLIDHJA ME DOKUMENTET E TJERA STRATEGJIKE

- Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit;
- Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Narkotikëve;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar;
- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia e Policimit në Bashkësi dhe Plani i Veprimit.

STRATEGJIA SI PRODUKT I BASHKËPUNIMIT ME PARTNERËT NDËRKOMBËTAR

Qeveria është e vetëdijshme se do të ketë nevojë për një mobilizim edhe të partnerëve kryesor të cilët tashmë janë të përfshirë në këtë fushë, duke kompletuar në tërësinë e vet dhe sipas praktikave të mira ndërkombëtare dhe vendore, ndërtimin dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale.

Organizatat ndërkombëtare dhe ato lokale joqeveritare do të jenë partner i rëndësishëm i qeverisë në zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme të kësaj strategjie. Qeveria e Kosovës, është e ndërgjegjshme se zbatimi i strategjisë do të kërkojë para se gjithash mobilizimin e burimeve të brendshme njerëzore e materiale, por realizimi i politikave të parashikuara në kuadrin e strategjisë do të kërkojnë edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, dhe institucioneve të specializuara ndërkombëtare deri në një periudhë të caktuar. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës angazhohet për një përdorim efektiv të kësaj mbështetje.

VIZIONI

Vizioni i kësaj strategjie, është “Ndërtimi i një shoqëri që jeton në paqe dhe pa kërcënime nga rreziqet që prekin sigurinë publike, personale, të pronës, sociale dhe mjedisit, duke krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt, multi-entik dhe multi-kulturor për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës”.

MISIONI

Misioni i strategjisë është “politik-bërja për të rritur sigurinë në bashkësi, koordinimi institucional të nivelit qendror dhe lokal, bashkërendimi i aktiviteteve me gjithë akterët që mbulojnë fushën e sigurisë në bashkësi, bërja e qytetarit pro-aktiv në propozimin e politikave të sigurisë, identifikimi me kohë i dukurive negative, forcimi i mëtejme i luftimit të krimit përmes mekanizmave ekzistues, të intensifikojë politikat parandaluese”.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Fuqizimi i kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë që merren me parandalim të dukurive negative me qëllim të uljes së nivelit të krimit dhe problemeve të siguri në bashkësi;
- Gjithë përfshirja e komuniteteve në mekanizmat e sigurisë në bashkësi;
- Koordinimi ndërinstucional në të gjitha nivelet dhe bashkëpunimi me qytetarë;
- Vetëdijesimi i qytetarëve për kërcënimet e sigurisë në bashkësi;
- Avancimi i bazës ligjore lidhur me mekanizmat e sigurisë në bashkësi.

QASJA E REKOMANDUAR

Qeveria e Republikës së Kosovës ka adaptuar këtë qasje, ku qytetari bëhet pjesë aktive e politik-bërjes në Fushën e sigurisë si dhe garanton një transparencë të përgjithshme në promovimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë. Objektivat e përcaktuara bëhen më lehtë të zbatueshme për faktin se kjo strategji përcakton qasje institucionale përmes mekanizmave profesional dhe kapaciteteve njerëzore të profilizuara në këtë fushë.

Arritja efikase e zbatimit të objektivave garantohej edhe me faktin se kjo strategji në PV ka të përcaktuar koston buxhetore të planifikuar si dhe të mbështetura në disa aktivitete përmes organizatave të ndryshme ndërkombëtare në Fushën e sigurisë. Qeveria e Republikës së Kosovës

në kuadër të prioriteteve strategjike ka siguruar koordinim ndërinstytucional në fushën e zbatimit të strategjive në përgjithësi duke unifikuar aktivitetet në afate kohore dhe me kosto të përballueshme në zbatimin e strategjisë.

Vazhdimësia e politikave strategjike në fushën e sigurisë në bashkësi ka garantuar një njohje me realitetin dhe rreziqet në mos zbatimin eventual, identifikimin me kohë të rreziqeve eventuale, si dhe njohja e mentalitetit qytetar dhe minimizim të rreziqeve në zbatimin e aktiviteteve strategjike. Gjithashtu, përmes planin të veprimit është bërë e mundur identifikimi dhe vlerësimi i ndikimit të rreziqeve përmes përcaktimit të masave për menaxhimin e rreziqeve të ndryshme. Akterët e strategjisë, të cilët mbulojnë fushën e sigurisë, janë të përfshirë në hartimin e politikave dhe në ofrimin e praktikave institucionale me qëllim zbatimit praktik dhe me kohë siç është e përcaktuar me planet dhe afatet kohore.

ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË-SISTEMII MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT

Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efikasitetit të aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponent kryesor të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

PROCESI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT, DO TË SHOQËROHET ME NGRITJEN DHE FORCIMIN E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Kjo është e nevojshme për faktin se:

- Pamjaftueshmëria e informacionit administrativ, në disa raste pasaktësia e tij, që shprehin një shkallë relativisht të ulët të zhvillimit të sistemit të unifikuar të informacionit dhe statistikave në Kosovë;
- Mungesa e përvojës për monitorim dhe vlerësim brenda institucioneve;
- Pamjaftueshmëria e vlerësimeve/studimeve të thelluara për çështjet e sigurisë në bashkësi.

DIMENSIONET KRYESORE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË STRATEGJISË JANË:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesë vjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm. Në fund të çdo viti, MPB-ja dhe Grupi Drejtues për Siguri në Bashkësi, përgatisin një raport progresi për shkallën e realizimit të objektivave;

Ministritë e linjës dhe akterët tjerë në strategji do të përgjigjen për monitorimin dhe për vlerësimin e aktiviteteve të cilat ju takojnë sipas mandatit.

Këto institucione do të raportojnë periodikisht tek Grupit Drejtues për Siguri në Bashkësi, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara;

Policia e Kosovës do të jetë organi kryesor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e trendëve kryesor që ndërlidhen me rritjen e sigurisë në bashkësi, si dhe për aspektet parandaluese dhe për ngritjen e vetëdijes së publikut.

Organizatat joqeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga MPB-ja. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqet raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet e realizuara.

ZGJEDHJA E TREGUESVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Disa nga treguesit përfundimtar janë:

- Hulumtimet e Opinionin Publik që caktojnë masën e besueshmëri ndaj Institucioneve Publike dhe të Sigurisë;
- Niveli/Shkalla e besueshmërisë në mes qytetarëve dhe PK-së;
- Raportet e takimeve të mbajtura nga kryetari komunës në KKSB dhe çështjet e adresuara;
- Raportet e hartuara nga KKSB dhe numri i projekt-propozimeve;
- Numri i KKSB, KLSP dhe EVSB, të themeluara dhe të funksionalizuara;

- Perceptimi i publikut ndaj rreziqeve në fushën e sigurisë në bashkësi;
- Siguria në shkolla dhe përmirësimi i vazhdueshëm;
- Komunikimi ndërinstytucional në lidhje me grumbullimin e informatave drejt kërcënimeve dhe sfidave reale;
- Forumet e sigurisë janë të njoftuara për strategjitë nacionale;
- Ekzistojnë raporte periodike statistikore;
- Numri i fushatave të organizuara;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin, përkatësisht në arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar në të dhëna dhe vrojtime, ato do të shpërndahen nëpërmjet përdorueseve të cilët do të jenë:

- Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale;
- Shoqëria civile;
- Partnerët ndërkombëtar;
- Mediat;
- Publiku i gjerë.

Përgjegjësit kryesor për shpërndarjen e rezultateve do të jenë:

MPB-ja, Grupi Drejtues për Siguri në Bashkësi.

Gjithashtu, publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet mediave ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë duke u angazhuar në mënyrë të veçantë.

ANALIZAT

PËRPARËSITË

- [Adresimi i problemeve në mënyrë të duhur nga qytetarët]
- [Gjithëpërfshirja e të gjithë akterëve të nivelit qendrorë dhe lokal]
- [Mbledhja e informatave nga niveli qendrorë dhe lokal]

DOBËSITË

- [Mungesa e burimeve njerëzore, nga institucionet qendrore dhe lokale]
- [Projektet me kosto të larta]

MUNDËSITË

- [Mekanizëm i mirë referues për institucionet relevante]
- [Mbështetja për zgjidhje të problemeve për qytetarët]

RREZIQET

- [Jetëgjatësia për arsye financiare]
- [MOS përkrahja financiare nga ndërkombëtarët dhe MOS ndarja e një linje buxhetore për projektet nga niveli Qendrorë]

Anex A

ANALIZAT KRAHASUESE TË VEPRAVE PENALE PREJ VITIT 2011-2015

Tabela nr.1. Statistikat e krahasuara vjetore sipas regjioneve për disa nga veprat penale më të shfaqura në territorin e Republikës së Kosovës, për periudhën Janar – Dhjetor **2011 - 2015**

Veprat penale / Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej
Vrasje	45	56	39	35	25	200
Dhunë familjare	995	998	1083	989	987	5052
Kanosje	2149	2044	1957	1986	1781	9917
Lëndimet	3522	3605	3257	3077	2857	16318
Vjedhjet	16164	15455	16112	14725	11385	73841
Grabitjet	514	472	493	404	347	2230
Dëmtim i pronës	3009	2619	2222	2410	2503	12763
Dhënie/marrje e ryshfetit	15	12	24	11	11	73
Dokument i falsifikuar	317	322	228	548	224	1639
Mashtrimi	609	567	584	582	505	2847
Keqpërdorim i dokumenteve	42	6	33	31	23	135
Kontrabanda me mallra	621	105	29	15	14	784
Sulm ndaj personit zyrtar	222	199	171	151	160	903
Pengim i personit zyrtar	328	338	309	280	236	1491
Arrestim i personit të kërkuar	3741	5315	4236	5123	4976	23391
Posedim i substancave narkotike	181	191	132	215	267	986
Gjetje e eksplozivëve/mjeteve të pashpërthyer	178	209	261	272	207	1127
Posedim ilegal i armëve	1339	1228	812	1080	911	5370
Pushtim i pronës	193	259	297	264	211	1224
Prishje e rendit-qetësisë publike	2656	2595	1477	1554	1342	9624
Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	1116	1367	588	596	433	4100

Anex B
Tabela nr. 2. Krahasimi i veprave mes viteve në %

Vitet	Vrasje	%	Dhunë familjare	%	Kanosje	%	Lëndimet	%	Vjedhje	%	Grabitje	%	Dëmtim i pronës	%
2011	45	22.5	995	19.7	2149	21.7	3522	21.6	16164	21.9	514	23.0	3009	23.6
2012	56	28.0	998	19.8	2044	20.6	3605	22.1	15455	20.9	472	21.2	2619	20.5
2013	39	19.5	1083	21.4	1957	19.7	3257	20.0	16112	21.8	493	22.1	2222	17.4
2014	35	17.5	989	19.6	1986	20.0	3077	18.9	14725	19.9	404	18.1	2410	18.9
2015	25	12.5	987	19.5	1781	18.0	2857	17.5	11385	15.4	347	15.6	2503	19.6
Gjithsej	200	100	5052	100	9917	100	16318	100	73841	100	2230	100	12763	100

Tabela nr. 3. Krahasimi i veprave mes viteve në %

Vitet	Dhënie/marrje e rryshfetit	%	Dokument i falsifikuar	%	Mashtrimi	%	Keqpërdorim i dokumenteve	%	Kontrabanda me mallra	%	Sulm ndaj personit zyrtar	%	Pengim i personit zyrtar	%
2011	15	20.5	317	19.3	609	21.4	42	31.1	621	79.2	222	24.6	328	22.0
2012	12	16.4	322	19.6	567	19.9	6	4.4	105	13.4	199	22.0	338	22.7
2013	24	32.9	228	13.9	584	20.5	33	24.4	29	3.7	171	18.9	309	20.7
2014	11	15.1	548	33.4	582	20.4	31	23.0	15	1.9	151	16.7	280	18.8
2015	11	15.1	224	13.7	505	17.7	23	17.0	14	1.8	160	17.7	236	15.8
Gjithsej	73	100	1639	100	2847	100	135	100	784	100	903	100	1491	100

Tabela nr. 4. Krahasimi i veprave mes viteve në %


Vitet	Arrestim i personit të kërkuar	%	Posedim i substancave narkotike	%	Gjetje e eksplozivëve	%	Posedim ilegal i armëve	%	Pushtim i pronës	%	Prishje e rendit dhe qetësisë publike	%	Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	%
2011	3741	16.0	181	18.4	178	15.8	1339	24.9	193	15.8	2656	27.6	1116	27.2
2012	5315	22.7	191	19.4	209	18.5	1228	22.9	259	21.2	2595	27.0	1367	33.3
2013	4236	18.1	132	13.4	261	23.2	812	15.1	297	24.3	1477	15.3	588	14.3
2014	5123	21.9	215	21.8	272	24.1	1080	20.1	264	21.6	1554	16.1	596	14.5
2015	4976	21.3	267	27.1	207	18.4	911	17.0	211	17.2	1342	13.9	433	10.6
Gjithsej	23391	100	986	100	1127	100	5370	100	1224	100	9624	100	4100	100

Anex C

Tabela nr.5. Krahasimet e llojeve të aksidenteve rrugore në Republikën e Kosovës për periudhën Janar – Dhjetor 2011 - 2015

Llojet e aksidenteve	Aksidentet me fatalitet	Aksidentet me lëndime	Aksidentet me dëme materiale	Godit dhe ik	Totali
2011	130	4490	13338	930	18888
2012	116	4555	14044	1039	19754
2013	104	4960	13878	1012	19954
2014	111	4876	10333	980	16300
2015	117	5266	11145	1185	17713
Gjithsej	578	24147	62738	5146	92609

Shiq shihet në tabelën nr.5




Grafikoni nr. 1. Statistikat e përgjithshme të aksidenteve rrugore në Republikën e Kosovës për periudhën Janar – Dhjetor 2011 - 2015

Anex D

Tabela nr.6. Krahasimi i numrit të viktimave sipas viteve (Janar – Dhjetor 2011 – 2015)

Viktimat	Personat e vdekur					Personat e lënduar					
	Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej		157	121	119	127	129	8321	8561	9817	9713	10671





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry Internal Affairs

Plani i Veprimit SNSB-së 2018 - 2023

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit €	Komentet
Objektivi Strategjik: 1. Fuqizimi i kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë që merren me parandalim të dukurive negative me qëllim të uljes së nivelit të krimit dhe problemeve në siguri në bashkësi						
1.1. Analiza për vlerësimin e kapaciteteve të forumeve të sigurisë	Raport vlerësues i gjendjes reale të kapaciteteve të forumeve të sigurisë	MPB	MAPL, Komunat, Organizatrat ndërkombëtare, Shoqëria Civile	K1 - K2	Donacion	UNDP,

1.2. Hartimi i programeve trajnuese standarde për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Miratimi i dokumenteve	MPB	AKSP, Organizatat ndërkombëtare partnere	2018	Donacion,	OSBE,
1.3. Ligjërimi për kadetët policor rreth forumeve të sigurisë, me theks të veçantë për KKSB dhe EVSB	Nr. i ligjëratave të mbajtura dhe numri i pjesëmarrësve	MPB	AKSP, PK	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	
1.4. Trajnimi për trajner të programit trajnues për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Numri i trajnerëve të certifikuar	MPB-AKSP	Organizatat ndërkombëtare partnere	2018-2023	1.845,	Për 3 vite,
1.5. Realizimi i trajnimeve për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Numri i trajnimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë, Komunat	MPB, AKSP Organizatat ndërkombëtare dhe vendore partnere	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	
1.6. Trajnimi i analistëve të DSP-së për zhvillimin e raporteve analitike	Numri i analistëve të trajnuar	MPB - AKSP	Organizatat ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Donacion,	UNDP,
1.7. Zhvillimi i raporteve analitike	Numri i raporteve analitike	MPB	DHS	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	

1.8. Themelimi dhe mbështetja e KKSB-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Numri i KKSB-ve të themeluara	MPB	MAPL, PK, Komunat, Organizatat ndërkombëtare partnere	2018-2023	Kosto administrative,	
1.9. Themelimi dhe mbështetja e EVSB-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Nr. EVSB-ve të themeluara	ICITAP	MPB, MAPL, PK, Komunat Organizatat ndërkombëtare partnere	K1-K3 2018	Donacion,	ICITAP,
1.10. Themelimi dhe mbështetja e KLSP-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Nr. KLSP-ve të themeluara	PK, OSBE	MPB, Komunat Organizatat ndërkombëtare partnere	2018-2023	Donacion,	OSBE,
1.11. Re-vitalizmi i forumeve të sigurisë.	Numri i forumeve të re-vitalizuara	MPB	MAPL, PK, Komunat, Organizatat ndërkombëtare partnere	Në vazhdimësi	6.000,	Për 3 vite,
1.12. Inkuadrimi i të gjithë koordinatorëve të forumeve të sigurisë në rrjetin telefonik pa pagesë	Nr. i të vendosurve në rrjet	MPB	PK	Në vazhdimësi	8.856,	Për 3 vite,

Objektivi Strategjik: 2. Përfshirja e vazhdueshme e komuniteteve në mekanizmat e sigurisë në bashkësi;

2.1. Realizimi i takimeve me anëtarët e komunitetit për pjesëmarrjen aktive në takimet e forumeve të sigurisë	Numri i takimeve dhe numri i pjesëmarrësve	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunitat, organizatat ndërkombëtare dhe vendore partnere	Në vazhdimësi	3.000,	Për 3 vite,
2.2. Identifikimi i shqetësimeve të sigurisë duke marrë për bazë aspektet gjinore.	Numri i aktiviteteve të realizuara	Forumet e Sigurisë	OJQ, PK, QPS, Komunitat	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	
2.3. Organizimi i fushatave të vetëdijesimit për mes aktiviteteve rekreative, kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetar	Numri i fushatave për vetëdijesim	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunitat, organizatat ndërkombëtare dhe vendore partnere	Në vazhdimësi	Donacion,	
2.4. Organizimi i tryezave të rregullta me të gjitha komunitetet	Numri i tryezave të organizuara	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunitat, organizatat	Në vazhdimësi	Komunitat, Donacion,	

për të qenë të informuar dhe për të bërë të mundur zbatimin e politikave pro-aktive dhe parandaluese			ndërkombëtare dhe vendore partnere			
2.5. Takimet e forumeve të sigurisë me përfaqësues të komuniteteve	Numri i takimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunat, organizatat ndërkombëtare dhe vendore partnere	Në vazhdimësi	Kosto Administrative ,	
2.6 Organizimi i rregullt i takimeve ndërmjet Ministrisë të MPB-së me anëtarët e forumeve të sigurisë	Nr. takimeve	MPB	Komunat, Forumet e Sigurisë,	Në vazhdimësi	4.200,	3 vite,
Objektivi Strategjik: 3. Koordinimi ndërinstitucional në të gjitha nivelet dhe në bashkëpunim me qytetarët;						
3.1. Përdorimi i formave standarde për shkëmbim të informatave kthyesë në mes të forumeve të sigurisë dhe institucionet e tjera.	Numri i raporteve të pranuara sipas formave standarde	Forumet e Sigurisë	MPB, MAPL	Në vazhdimësi	Kosto Administrative,	

3.2. Organizimi i rregullt i Këshillit Ekzekutiv të EVSB-ve	Së paku një (1) në vit	EVSB	MPB, Komunitat, OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	1.500,	Për 3 vite,
3.3. Organizimi i takimeve ndërmjet forumeve të sigurisë me komunitat fqinje	Nr. takimeve	Forumet e Sigurisë	Komunitat, MPB, MAPL	Sipas nevojës	Komunitat, Kosto Administrative,	
3.4. Organizimi i takimeve ndërmjet anëtarëve të forumeve të sigurisë dhe shoqërisë civile për të trajtuar çështjet e sigurisë në bashkësi	Së paku 1 takim në vit	Forumet e Sigurisë	Komunitat, OJQ, MPB, PK, MAPL	vazhdimësi	Kosto Administrative,	
3.5. Organizimi i seminarit me komunitetin e biznesit për rolin e forumeve të sigurisë dhe mundësive të bashkëpunimit për çështjet e sigurisë	Seminari i realizuar	MPB	Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB),	Së paku njëherë në vit	Donacion,	

3.6. Ngritja e kapaciteteve dhe përfshirja e forumeve të sigurisë në identifikimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm me bazë në komunitet	8 trajnime dhe 8 punëtori të realizuara në 7 regjionet e Kosovës (8 komuna)	AME, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	5.400, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
3.7. Organizimi i konferencës vjetore në mes të MPB-së dhe kryesuesve të KKSB-së	Konferenca e realizuar (se paku 1 në vit)	MPB	MAPL, Komunitat, Partnerët Ndërkombëtar,	Në vazhdimësi	2.400, Donacion,	Për 2 vite MPB, OSBE 2017,
3.8. Pjesëmarrja në takimet rajonale (ndërshtetërore) për shkëmbimin e përvojave lidhur me fushën e sigurisë në bashkësi.	Nr. takimeve të realizuara	MPB	Partnerët Ndërkombëtar	Në vazhdimësi	MPB, Donacion,	
3.9. Sigurimi i mbështetjes financiare nga MPB, me participim nga komuna për mbështetje të	Fondi i siguruar	MPB	MAPL, Komunitat, partnerët ndërkombëtar, OJQ,	Në vazhdimësi	150.000 MPB , 75.000 Komuna, si dhe Donacion,	Për 3 vite,

projekteve të forumeve të sigurisë për sigurinë në bashkësi						
3.10. Ndarja e mirënjohjeve për kontributin në aktivitetet e sigurisë në bashkësi	Nr. i mirënjohjeve të ndara	MPB	Forumet e sigurisë, komunat	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	

Objektivi Strategjik: 4. Vetëdijesimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës për kërcënimet relevante të sigurisë në bashkësi;

4.1. Identifikimi i kërcënimeve relevante të sigurisë dhe përparësia e tyre	Raporti për kërcënimet e identifikuar nga të gjitha KKSB	KKSB	forumet e sigurisë, PK,	K4, Në vazhdimësi	Kosto administrative,	
4.2. Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit për adresimin e kërcënimeve të identifikuara.	Nr. i planeve të hartuara nga KKSB,	KKSB	MPB, Forumet e sigurisë, PK,	K1- në vazhdimësi	Kosto administrative,	

4.3. Zhvillimi i modelit nacional të Planit për Menaxhim të Fatkeqësive në Shkolla	Modeli i hartuar dhe i aprovuar nga bartësit e përgjegjësive	AME dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	5.240, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
4.4. Zbatimi i aktiviteteve konkrete nga planet e veprimit	Nr. i aktiviteteve të realizuara	KKSB	Forumet e Sigurisë, PK	Në vazhdimësi	Komunitat, Grante dhe Donacion,	
4.5. Krijimi i platformës "online" ku qytetarët kanë mundësi t'i adresojnë çështjet e tyre në fushën e sigurisë	Platforma e krijuar	MPB	MAPL, partnerët ndërkombëtar	2018 - 2023	MPB - IT dhe Donacion,	UNDP,
4.6. Pilotimi i Planit për Menaxhim të Fatkeqësive dhe mbështetja e Shkollave për krijimin e ekipeve për menaxhimin e emergjencave	15 institucione arsimore kanë krijuar planet, 15 institucione arsimore kanë themeluar ekipet për menaxhim të Emergjencave	AME, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	100.000, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
4.7. Organizimi i takimeve informuese për media në lidhje me Strategjinë për	Nr. i takimeve informuese të realizuara	MPB-ZIP	MAPL, PK	K1 - 2018	Kosto administrative,	

Siguri në Bashkësi						
4.8. Organizimi i takimeve të rregullta me përfaqësues të mediave lidhur me problemet e sigurisë	Nr. takimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB-ZIP, zyrat komunale për informim	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	
4.9. Sesione informative për rolin dhe përgjegjësitë e forumeve të sigurisë në institucionet para universitare dhe universitare	Numri i sesioneve të realizuara	MPB	MASHT, PK, Organizatat studentore	2018	Kosto administrative,	
4.10. Sensibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë e sjelljet e dhunshme përmes organizimit të ligjëratave në shkolla, debateve dhe kampeve	Numri i aktiviteteve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB MASHT PK	Në vazhdimësi	Kosto Administrative, Donacion,	

4.11. Organizimi i fushatës për vetëdijesimin e përdorimit të sigurt të fishekzjarrëve	Realizimi i fushatës	MPB	MASHT, Komunat, Forumet e Sigurisë	K4-2017-2023	15.000, 23.966.11,	për 3 vite, Përdorimi dat. (26.12.2017-02.01.2018)
--	----------------------	-----	--	--------------	-----------------------	--

Objektivi Strategjik: 5. Avancimi i bazës ligjore lidhur me mekanizmat e sigurisë në bashkësi;

5.1. Themelimi i GP për vlerësimin dhe harmonizimin e zbrazëtirave ligjore si dhe nevojat e plotësimit ndryshimit të bazës ligjore	Raporti vlerësues	MPB	MAPL PK Forumet e sigurisë AKK	K1-2018	Kosto administrative,	
--	-------------------	-----	---	---------	-----------------------	--